



Fakulteti i Mjekësisë
Universiteti i Prishtinës

RAPORT I PUNËS

**RAPORT I PUNËS SË MENAXHMENTIT TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË
GJATË PERIUDHËS KOHORE: 1 JANAR 2019 – 31 JANAR 2019**

DEKANJA

AKTIVITETI NË SFERËN AKADEMIKE-SHKENCORE	2
Aktiviteti: Përmbledhje e aktiviteve dhe implementimi i strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020	2
Aktiviteti: Vazhdimi i Reformave në vlerësimin e studentëve	4
Aktiviteti: Akreditimi i programeve të Fakultetit të Mjekësisë	5
Aktiviteti: Pranimi i studentëve në FM	6
Aktiviteti: Zgjedhja dhe avancimi i stafit akademik në FM	8
Aktiviteti: Transferet e jashtme në FM	9
Aktiviteti: Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë	10
Aktiviteti: Angazhimet e ndryshme vendore	20
Aktiviteti: Implementimi i iniciativave të ndryshme të realizuara në Fakultetin e Mjekësisë	23
Aktiviteti: Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimorë	23
Aktiviteti: Përpilimi i raporteve F1, F2, F3	24
Aktiviteti: Krijimi i Monografisë së Fakultetit të Mjekësisë	24
AKTIVITETI NË SFERËN PROFESIONALE SHËNDETËSORE	26
Aktiviteti: Takime pune me Drejtorin ekzekutiv të SHSKUK-se dhe Bordin e SHSKUK	26
Aktiviteti: Takime pune me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Shkencës Arsimit dhe Teknologjisë	27
Aktiviteti: Takime pune me Odën e Mjekëve të Kosovës	28
Aktiviteti: Organizimi i edukimit të vazhdueshëm profesional nga Fakulteti i Mjekësisë	29
AKTIVITETI NË SFERËN E INFRASTRUKTURËS DHE FINANCAVE	29
SHTOJCA 1: Inventari në Dekanatin e ri 2019	42
SHTOJCA 2: Inventari për Fakultetin e Mjekësisë 2019	50
SHTOJCA 3: Materiali laboratorik 2019	56
SHTOJCA 4: Materiali shëndetësor 2019	74
SHTOJCA 5: Pajisjet e IT 2019	83
SHTOJCA 6: Pajisjet laboratorike 2019	84
SHTOJCA 7: renovimet 2019	93

AKTIVITETI NË SFERËN AKADEMIKE-SHKENCORE

Aktiviteti: Përmbledhje e aktiviteteve dhe implementimi i strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020

Gjatë vitit 2019, Menaxhmenti i Fakultetit të Mjekësisë, vazhdoi aktivitetet e fokusuara rreth implementimit të Strategjisë Zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë. Përveç vazhdimit të konsolidimit të rezultateve të arritura gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018, gjatë vitit 2019 menaxhmenti i FM-së, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë shefat e degëve dhe katedrave të FM-së, u fokusua në arritjen dhe plotësimin e këtyre aspekteve të strategjisë zhvillimore:

- Përmirësimin a nevojave kadrovike të FM-së;
- Modernizimin dhe ngritjen e interaktivitetit në procesin e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në FM;
- Përfundimi i ndërtesës së Dekanatit;
- Përmirësimin e infrastrukturës, inventarit dhe furnizimit me pajisje të nevojshme për mbarëvajtjen dhe ngritjen e cilësisë në mësimdhënje dhe mësimnxënje dhe
- Intensifikimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtarë.

Strategjia në fjalë ishte përpiluar me marrjen e detyrës nga menaxhmenti i tanishëm, në vitin 2016. Kjo strategji është prezantuar para partnerëve ndërkombëtarë dhe ka marrë edhe vlerësime të larta.



Rezultatet e implementimit të strategjisë zhvillimore të FM gjatë vitit 2019:

- *Ngritja dhe konsolidimi i kapaciteteve kadrovike në FM;*
- *Finalizimi i punëve rreth ndërtesë së re të Dekanatit;*
- *Implementimi i mëtutjeshëm i mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në formë interaktive sidomos në fushën e anatomisë, embriologjisë, radiologjisë, fiziologjisë patologjike dhe anatomisë patologjike nëpërmjet aplikimit të teknologjisë më të avancuar;*
- *Vazhdimi i pranimit të studentëve në baza meritore dhe duke respektuar në plotësi kriteret e përcaktuara;*
- *Përmirësimi i infrastrukturës në FM gjatë vitit 2019;*
- *Vazhdimi i ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Mjekësisë;*
- *Mbështetja dhe angazhimi në ngritjen e punës kërkimore në FM sidomos në aspektin e zgjerimit të kontakteve me partnerë rajonal dhe ndërkombëtarë;*
- *Bashkëpunimi me organizata profesionale me qëllim të rritjes së mundësive të studentëve tonë për të kryer punë praktike profesionale;*
- *Adresimi i kërkesave të katedrave në raport me përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik në realizimin e mësimin dhe punës kërkimore;*
- *Përmirësimi i furnizimit të pajisjeve laboratorike;*
- *Përmirësimi i furnizimit të mjeteve të IT.*

Aktiviteti: Vazhdimi i Reformave në vlerësimin e studentëve

a) Zbatimi i rubrikave e vlerësimit

Gjatë gjithë vitit 2019, vazhdoi zbatimi me sukses i vlerësimit të temave të diplomës. Këto vlerësime u realizuan nga komisionet përkatëse me rastin e mbrojtjes së temës së diplomës nga ana e kandidatëve. Rubrikat e vlerësimit të studentëve u dizajnuan gjatë vitit 2017 në kuadër të aktiviteteve për ngritjen e cilësisë në punën që dorëzohet nga studentët.

Me rastin e auditimit të mbrojtjes së temave të diplomës, është konstatuar që si rrjedhojë e procedurave të dizajnuara, asnjë nga studentët nuk ka mbrojtur temën e diplomës pa ju nënshtruar procesit të vlerësimit sipas standardeve të parapara me formularët e vlerësimit dhe rubrikat e vlerësimit të studentëve.

Sqarim: Rubrika e vlerësimit është një instrument i dizajnuar nga Komisioni i Studimeve i Fakultetit të Mjekësisë. Kjo rubrikë është dizajnuar me qëllim të përcaktimit të kriterëve themelore gjatë vlerësimit të studentëve me rastin e prezantimit të punës së tyre seminarike apo me rastin e mbrojtjes së temave të diplomës. Ky sistem mundëson vendosjen e vlerësimeve numerike në raport me përshkruesit specifik të performancës së studentëve dhe mundëson një llogaritje më objektive të poentimit dhe notimit të studentëve gjatë prezantimit të punës së tyre. Duke siguruar një uniformitet dhe standard ndërmjet vlerësuesve të ndryshëm të të njejtit student, rubrika e vlerësimit gjithashtu ndikon pozitivisht në aspektin e mbrojtjes së integritetit akademik gjatë procesit të vlerësimit të studentëve (shih shtojcën e bashkangjitur).

b) Vlerësimi i vazhdueshëm i studentëve dhe aplikimi i syllabuseve

Gjatë vitit akademik 2018/2019, kanë vazhduar me intensitet të shtuar aktivitetet rreth zbatimit të vlerësimit të vazhdueshëm në Fakultetin e Mjekësisë. Në rastet kur syllabuset e lëndëve përkatëse nuk e kanë paraparë vlerësimin e vazhdueshëm atëherë nga Profesorët i kanë përditësuar ato për të përfshijë komponentet e vlerësimit të vazhdueshëm gjatë vitit akademik. Duhet theksuar se një gjë e tillë është paraparë edhe me rekomandimet e Agjencisë së Akredimitit dhe në përgjithësi nga rekomandimet që ndërliken me cilësinë në arsimin e lartë.

c) Zbatimi i formularëve të vlerësimit

Gjatë vitit akademik 2018/2019 ka vazhduar implementimi i formularëve të vlerësimit të studentëve nga ana e profesorëve. Gjatë vitit akademik, Dekanati ka organizuar auditime të randomizuara në lidhje me zbatueshmërinë e aplikimit të formulareve të vlerësimit.

Me rastin e auditimit të katedrave përkatëse, është konstatuar që ende ka nevojë që stafit ti ngritet vetëdija rreth aplikimit të formularit të vlerësimit dhe mbajtjes së atij formulari në dispozicion për auditim. Presim që gjatë vitit akademik 2019/2020, komplainca në aspektin e përdorimit të formulareve të vlerësimit të jetë e plotë.

Aktiviteti: Akreditimi i programeve të Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Në nëntor të vitit 2019, Fakulteti i Mjekësisë caktoi Task Forcën për akreditim të programeve të FM-së. Kryesues i kësaj Task Force u zgjodh Prof Asoc Dr Kreshnik Hoti. Nëpërmjet kësaj task Force, FM synon që të ngrisë seriozitetin dhe rezultatet nga procesi i akreditimit të programeve të FM-së. Në fund të muajit Dhjetor, FM do të aplikojë për reakreditim të programeve: Biomjekësi Eksperimentale (niveli PhD), Shëndet Publik (niveli PhD), Mami (niveli Bachelor – akreditim), Infermieri (niveli Bachelor), Fizioterarpi (niveli Bachelor) dhe Fizioterapi (niveli Master – akreditim). Raportet e Task Forcës për reakreditim janë proceduar edhe në Rektorat.

Aktiviteti: *Pranimi i studentëve në FM*

Përshkrimi i aktivitetit: Për vitin akademik 2019/2020, Fakulteti i Mjekësisë ka përmbyllur me sukses procesin e regjistrimit të studentëve në nivelin e studimeve themelore, studimeve master dhe studimeve të doktoratës. Pranimi i studentëve, proces ky i cili historikisht ka kaluar nëpër faza të vështira në FM, edhe këtë vit është përfunduar me sukses nga ana e menaxhmentit të FM, duke respektuar në përpikshmëri udhëzimet dhe konkursin e shpallur nga Rektorati, si dhe duke respektuar rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Kjo ka vazhduar të kontribuoj pozitivisht në ngritjen dhe ruajtjen e kredibilitetit të FM në këtë proces. Kësaj here, kryetar i komisionit për pranimin e studentëve në studimet themelore ishte Prof Ass Dr Burim Neziri.

Ekipi punues gjatë provimit pranues të afatit të parë (karantina 24 orë).



Ekipi punues gjatë provimit pranues të afatit të dytë (karantina 24 orë).



Në aspektin e realizimit të provimeve pranuese për studentët e vitit akademik 2019/2020 në FM, vlen të theksohen edhe faktet si në vijim:

- Ne afatin e parë të konkursit për pranim pa rritje të numrit të studentëve në FM janë pranuar **276** studentë në pesë drejtime të ndryshme.
- Ne afatin e parë të konkursit për pranim me rritje të numrit të studentëve në FM janë pranuar **353** studentë në pesë drejtime të ndryshme.
- Ne afatin e dytë konkursit për pranim të studentëve në FM janë pranuar 132 studentë.
- Gjithsejt në afatin e parë dhe dytë janë pranuar 485 studentë;
- Është organizuar provimi pranues për studentë të nivelit master dhe janë pranuar 30 studentë
- Është organizuar provimi pranuese për studentë të nivelit të doktoratës, në të cilat janë pranuar **31** studentë.

Aktiviteti: Zgjedhja dhe avancimi i stafit akademik në FM

Sikurse edhe viteve të kaluara edhe gjatë vitit 2019, në vazhden e adresimit të strategjisë zhvillimore të FM-së, synim qëndrorë vazhoi të mbetë edhe ngritja e kapaciteteve të mësimdhënjes. Në këtë aspekt, vlenë të theksohet se gjatë dekadave të fundit, stafi i FM-së nuk është përtrirë në raport me nevojat si dhe në raport me stafin e pensionuar. Kjo ka ndikuar në nevojën për shumë angazhime dhe shfrytëzim të stafit ekzistues për të mbajtur orë mbinormë. Duke konsideruar këto aspekte, katedrat e FM-së, me kërkesë të Dekanatit, rishikuan orët në dispozicion për stafin akademik në përpikshmëri. Rrjedhimisht, katedrat bënë kërkesat e tyre kadrovike në Dekanat. Kështu u bë menaxhimi i suksesshëm i aktiviteteve për shpalljen e konkursit për staf akademik të rregullt. Aktualisht ky konkurs për stafin akademik të rregullt është në procedurë e sipër.

Në këtë konkurs të shpallur nga UP-ja për staf akademik të rregullt janë 57 pozita për të gjitha drejtimit e FM, nga të cilat 44 pozita për rizgjedhje të stafit ekzistues (skadim kontrate); dhe 13 pozita të reja.

Ndërsa, në konkursin e shpallur për staf akademik të angazhuar (bashkëpunetorë të jashtëm) për të gjitha drejtimit e FM ishin gjithsej 31 pozita. Ky konkurs për bashkëpunetorë të jashtëm tashme është i përfunduar me sukses.

Menaxhmenti i FM-së synon të mirëmbajë transparencën në procesin e zgjedhjes së stafit akademik duke përfshirë këtu edhe sigurimin e përzgjedhjes së stafit në baza meritore. Kjo do të ndikojë pozitivisht në ndërtimin e mëtutjeshëm të reputacioni të Fakultetit të Mjekësisë si dhe ngritjes së kapaciteteve kadrovike në FM. Në këtë aspekt, FM ia arriti që ndieshëm të ngrisë kapacitetet kadrovike të FM-së gjatë viteve të fundit.

Gjithashtu vlenë të theksohet se gjatë vitit 2019 me sukses u integruan stafi i ri i avancuar në konkursin e vitit 2018, gjatë të cilit konkurs u avancuan 25 Profesorë asistentë të rinj, nga të cilët 18 femra. Gjatë vitit 2019, u vërejt një përmirësim kadrovik si pasojë e avancimit të këtij stafi gjë që kontribuoj në ngritjen e cilësisë në mësimdhënje në Fakultetin e Mjekësisë.

Aktiviteti: *Transferet e jashtme në FM*

Transferet e jashtme sikurse edhe viteve të kaluara ishte kryesisht nga Fakulteti i Shkencave Mjekesore - Universiteti i Tetovës në Fakultetin e Mjekësisë - UP "Hasan Prishtina". Ky transfer edhe gjatë vitit 2019 ishte bazuar në kriteret e parapara në Vendimin e senatit të UP-së me nr prot. 2/640 te dt. 28.09.2018. Në këtë aspekt, janë transferuar gjithsej 38 student – drejtimi Mjekësi e Përgjithshme, nga te cilët në vitin e III-të janë transferuar 14 studentë, vitin IV-të u transferuan 12 studentë, dhe në vitin e V-të 13 studentë. Nga Universiteti i Tiranës në Fakultetin e Mjekësisë është transferuar 1 student.

Transferet e jashtme nga Fakulteti i Shkencave Mjekesore - Universiteti i Tetovës në Fakultetin e Mjekësisë - UP "Hasan Prishtina" në drejtimin Farmaci - 2 student. Ndersa në drejtimin Stomatologji janë transferuar 11 studentë. Pra gjithsej u transferuan 52 studentë në të gjitha drejtimet e Fakultetit të Mjekësisë.

Transfere të brendshme (brenda UP –"Hasan Prishtina) nga drejtimi Stomatologji në drejtimin Mjekësi e Pergjithme , viti III-të, është bërë një trasfer.

Në programin e studimeve master: Edukimi në Kujdesin Shëndetësor ne drejtimin Infermieri janë pranuar 19 kandidatë, dhe 1 kandidate nga komuniteti jo-shumicë (gjithsej 20 studentë); Në drejtimin Mami janë pranuar 5 kandidatë, dhe në drejtimin Fizioterapi janë pranuar 5 kandidatë. Gjithsej janë pranuar 30 studentë, përfshirë edhe pozitat e percaktuara për minoritete të planifikuara me konkurs.

Aktiviteti: Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë

Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësië është një nga prioritetet kyqe të menaxhmentit të FM. Kjo është specifikuar edhe në strategjinë zhvillimore të Fakultetit. Në këtë aspekt, gjatë vitit 2019, menaxhmenti ka realizuar këto aktivitete konkrete:

Vizitë pune në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetërorrë të Tetovës




Vizite pune në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë



Pjesëmarrja në Takimin e Pestë Vjetor të Asociacionit të Universiteteve të Ballkanit (BUA), i cili u mbajtë më 16-18 Prill 2019, në Selanik, Greqi.



Prezantimi si “powerful speaker” ne kuader te “Global Health Catalyst Summit” i organizuar nga Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Harvardit dhe pjesëmarrja në panel diskutime



Vizite Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Northeastern University në Boston.

Inicimi i bashkëpunimit në fushën e farmacisë, infermierisë dhe fizioterapisë.



Tribuna me titull: "Emancipimi dhe zhvillimi i femrës shqiptare, synimi i Evropianizimit të kombit duke u ndalur në rendësinë e edukimit tradicional në familjet shqiptare dhe edukimin shkollor" e organizuar në Zagreb, Kroaci.



Vizite pune një javore e eksperteve nga “Geisel School of Medicine at Dartmouth”. Gjatë takimit morën pjesë:

Prof. Dr. Mary Chamberlin, Oncologist, Medical Director, Oncology-Hematology/Geisel School of Medicine, Dartmouth University, NH, USA

Prof. Dr. Ruth Thompson, Medical Director of The Jack Byrne Center for Palliative & Hospice Care/Dartmouth

Linda Kennedy, Associate Director of Community affairs, Dartmouth

Prof. Megan Romano, Environmental epidemiologist, Dartmouth

Anne Sosin, Global Health Initiative, Program Director, Dickey Center for International Understanding/Dartmouth College



Konferenca e organizuar me ekspertët nga Dartmouth me titull:
"Multidisciplinary Approach to Early Detection and Screening of Breast Cancer"!



Prezantimi në Kongresin e 31 Evropian të Patologjisë në Nice të Francës



Samiti i Lidereve Botëror për Kancer, Kazakistan, organizuar nga Unioni Internacional kundër Kancerit (UICC)



Simpoziumi Mjekësorë Internacional i bashkorganizuar me KFOR-in Amerikan në Bondsteel



Aktiviteti: Angazhimet e ndryshme vendore

Menaxhmenti i Fakultetit të Mjekësisë gjithashtu u angazhua në shumë aktivitete të ndryshme vendore që kanë të bëjnë me çështjet zhvillimore dhe me interes për Fakultetin e Mjekësisë. Më poshtë janë paarqitur disa nga këto aktivitete:

Tryeza "Sfidat në Mjekësi dhe Bujqësi nga perspektiva akademike"



Tryeza e diskutimit “Shteti i Kosovës për shëndetin e qytetarëve”, organizuar nga Instituti për Hulumtime Sociale “Paragon”, në bashkëpunim me Fondacionin “Friedrich Ebert”.



Konferenca e Task Forcës Mediterane për Kontroll të Kancerit (MTCC) me titull: “Early occurrence of colorectal cancer “

Prezantimi me titull: “The rising incidence of colorectal cancer in young adults in Kosovo”



Seminari “Roli i grave në Shkencë, Arsim të Lartë dhe transformim shoqërorë”



Tryezë e organizuar nga CPC: Hulumtimi mbi integritetin akademik



Promovimi i doktorantëve të Fakultetit të Mjekësisë



Aktiviteti: *Implementimi i iniciativave të ndryshme të realizuara në Fakultetin e Mjekësisë*

Gjatë vitit 2019, në Fakultetin e Mjekësisë vazhduan të implementohen aktivitetet e ndryshme në qendrën për simulim dhe zhvillim të shkathtësive klinike – qendër e parë e këtij lloji në Kosovë si dhe në e-laboratorin e FM-së. Qëllimet e parësore të qendrës për simulim dhe zhvillim të shkathtësive klinike janë që të përmirësohet mësimdhënja dhe mësimnxënja e shkathtësive klinike duke simuluar ambiente reale, që u mundeson studentëve të ushtrojnë teknika të ndryshme klinike në modele trupore (mullazhe), para se ata të angazhohen në praktikën klinike me pacientë të vërtetë. Në anën tjetër, ndër qëllime kyçe të e-laboratorit ishte kyqja e teknologjisë informative në procesin e edukimit shëndetësorë që ofron FM si dhe ndihmesën në ndërrkombëtarizimin e FM duke u ofruar studentëve qasje në ligjerus të ndryshëm nga mbarë bota.

Aktiviteti: *Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimorë*

Përshkrimi i aktivitetit:

1. Fakulteti i Mjekësisë vazhdoi monitorimin e rregullt të procesit mësimorë. Drejtuar nga Prodekani për mësim, ekipet mobile të monitorimit, të themeluara qysh nga viti 2017, vazhduan me sukses monitorimin dhe auditimin e randomizuar të procesit mësimorë në të gjitha degët e Fakultetit të Mjekësisë. Këto ekipe përbëhen nga 2 Profesorë të degëve të ndryshme, një asistent dhe një përfaqësues të Keshillit të studentëve. Përveq ekipeve mobile monitoruese, ka vazhduar edhe monitorimi nga ana e shefave të katedrave dhe shefave të Degëve. Implementimi i ID kartelave në monitorimin e mësimit gjithashtu është duke u kryer me sukses në FM. Gjatë vitit 2019, kujdes të veçant i është kushtuar edhe mbarëvajtjes së stafit akademik, dhe duke u bazuar edhe në rekomandimet nga Auditori i brendshëm i UP-së, u kërkua nga cdo katedër që të raportojnë në baza javore mbi ardhje-vajtjen e stafit akademik në punë. Gjithashtu u bë mbikqyrja e sallave të mësimit nëpër Klinika dhe Amfiteater si nga aspekti i higjienes, infrastrukturës ashtu edhe i respektimit të orarit të mësimit.

Aktiviteti: Përpilimi i raporteve F1, F2, F3

Përshkrimi i aktivitetit: Procesi i përpilimit të raporteve F1,2,3 është përmbyllur me sukses nga ana e Dekanatit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha katedrat. Gjatë këtij procesi, janë konsultuar individualisht shefat e katedrave përkatëse me ç'rast janë finalizuar raportet e orëve të stafit akademik për vitin akademik 2019/2020.

Raportimi i sakt i orëve në formularët F1, F2 dhe F3 siguron një pasqyre më të saktë të angazhimit të stafit. Kjo është esenciale dhe siguron një planifikim më të mirë kadrovik, përkatësisht zhvillim dhe planifikim kadrovik më afat-gjatë të Fakultetit të Mjekësisë.

Aktiviteti: Krijimi i Monografisë së Fakultetit të Mjekësisë

Menaxhmenti i FM në vitin 2019 mori iniciativën e krijimit të Monografisë të Fakultetit të Mjekësisë, me rastin e 50 vjetorit të themelimit të Fakultetit. Në këtë Monografi do të prezantohet historiku i FM, degëve përkatëse, si dhe do të përshkruhen degët dhe katedrat përkatëse të Fakultetit të Mjekësisë që nga fillimi e deri më tani. Aktivitetet për përpilimin e Monografisë së FM janë duke u koordinuar nga Prodekanja Prof. D.r Gloria Staka.



Vlen të theksohen edhe aktivitetet tjera të rregullta të kryera nga menaxhmenti i FM-së, si në vijim:

- Pjesëmarrja dhe menaxhimi i mbledhjeve të Këshillit Shkencor-Mësimor të Fakultetit të Mjekësisë, si dhe takime të rregullta me Shefa të Degeve: Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji, Farmaci, Fizioterapi dhe Infermieri;
- Pjesëmarrja e rregullt në mbledhje të kolegjiut të Dekanëve dhe Senatit;
- Pjesëmarrja e rregullt në ceremonitë e promovimit të doktorantëve;
- Pjesëmarrja e rregullt në ceremonitë e diplomimit të studentëve;
- Pjesëmarrja në procesin e provimit pranues;
- Menaxhimi i Komisionit të Studimeve Themelore të Fakultetit të Mjekësisë;
- Menaxhimi i Komisionit të Këshillit të doktoratave të FM;
- Emërimi i komisioneve për monitorimin e vijueshmërisë së procesit mësimor të personelit akademik në gjitha degët e FM;
- Pjesëmarrja rreth punëve të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërtimin e objektit të ri të Dekanatit;
- Pjesëmarrje në komisione dhe grupe punuese tjera relevante në Dekanat dhe Rektorat.

AKTIVITETI NË SFERËN PROFESIONALE SHËNDETËSORE

Gjatë vitit 2019, menaxhmenti i FM-së mori pjesë në aktivitete të ndryshme të sferës shëndetësore. Në këtë aspekt vlen të përmenden aktivitetet si:

Aktiviteti: *Takime pune me Drejtorin ekzekutiv të SHSKUK-së dhe Bordin e SHSKUK*

Gjatë këtyre takimeve të rregullta janë diskutuar shumë çështje si:

- përmirësimi i përvojës klinike të studentëve të FM;
- caktimi i lokacionit për objektin e degës së Farmacisë të Fakultetit të Mjekësisë për të cilin kishim edhe aprovimin e mëhershëm;
- diskutimi lidhur me asistentët e rregullt të FM për punësim të rregullt në shëndetësi;
- diskutimi i problemeve të krijuara lidhur me asistentet e degës së Stomatologjisë ku është biseduar për problemin e stafit të angazhuar në pjesën akademike, por jo edhe në atë shëndetësore dhe ju është dhënë lista e stafit;
- lirimi i hapësirave të dedikuara për stafin akademik dhe për studentët, nëpër të gjitha klinikat e QKUK-së, me theks sallat e studentëve në ish klinikën e Mjekësisë Interne (Kardiologjisë kati I dhe II si dhe Klinikës së Anestezionit);
- aktivizimin i pilot-projektit të zyrës për qendrën informative të barnave dhe për mundësin e futjes së këtij pilot-projekti në statutin e QKUK-ës;
- mbarëvajtja e punës në arsim dhe shëndetësi për harmonizim e interesave të FM dhe SHSKUK-se dhe jemi dakorduar për çdo kërkesë nga cila do palë të takohemi në afatin sa më të shpejtë të mundshëm fizikisht për zgjidhjen e problemit të krijuar;
- zgjidhja e problemit me Termokosin, KEK- dhe Kompaninë e Ujit Prishtina për objektin e ri të Dekanatit.
- shfrytëzimin sa më të mirë të kapaciteteve profesionale dhe logjistike të QKUK-së për nevojat e studentëve të FM-së;
- problemet infrastrukturore;
- interpretime të ndryshme ligjore

- uzurpimi i hapësirave të dedikuara për studentët dhe stafin akademik;
- harmonizimit të interesave të FM dhe SHSKUK-së etj...

Aktiviteti: Takime pune me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Shkencës Arsimit dhe Teknologjisë

Gjatë vitit 2019 u organizuan takime të ndryshme ndërmjet menaxhmentit të FM-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Për shembull, me MSH u diskutua rreth zvoglimit të personelit akademik nëpër klinikat e QKUK-sëe, pastaj organizimin e ligjëratave për specializantë nga FM dhe rritjen e numrit të studentëve në vitin e parë për degët e caktuara në FM. Me MASHT përveç tjerave gjithashtu u diskutua rreth planifikimit dhe realizimit të programit shtesë për grupin e biologëve ku pjesëmarrës kanë qenë përveç menaxhmentit të FM edhe prorektori për mësim z. Prof Hysen Bytyqi, koordinatori e programit Prof. ass. dr. Zana Baruti-Gafurri dhe Sekretari i FM Z. Visar Muqaj.

Takim pune me Ministrin e Arsimit, Shkences dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrin e Shëndetësisë lidhur me shtimin e numrit të studentëve të Mjekësisë së përgjithshme dhe të Infermierisë për shkak të migrimit të madh të këtyre dy profileve.



Aktiviteti: Takime pune me Odën e Mjekëve të Kosovës

Menaxhmenti i FM gjithashtu mori pjesë në takime të ndryshme të Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK), nëpërmjet Prodekanit për çështje Shëndetësore Prof Asoc Dr Ibrahim Rudhan, i cili gjithashtu është zgjedhur edhe kryetar i komisionit për licencim të profesionistëve shëndetësorë në OMK. Gjatë këtyre takimeve FM është angazhuar për implementimin e kërkesës së Këshillit të FM rreth vendosjes së thirrjeve shkencore dhe akademike në faksimila.

Në vazhden e aktiviteteve të sferës shëndetësore profesionale, kryesia e trupës keshilldhënëse ka organizuar një test për evaluimin e përgatitjes profesionale dhe shkathtësive mjekësore të studentëve që përfundojnë FM (Mjekëve, stomatologëve, Infermierëve, Fizioterapeutëve), nga ku do të vlerësohen dhe përpunohen të dhënat nga këto rezultate si dhe do të plotësojmë ose korigjojmë kurrikulat tona në bazë të këtyre sygjërimeve.

Aktiviteti: *Organizimi i edukimit te vazhdueshëm profesional nga Fakulteti i Mjekësisë*

Përshkrimi i aktivitetit: Fakulteti i Mjekësisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019 me implementimin e ciklit mujor të organizimit të seminareve nga profilet e ndryshme shëndetësore, nën mbikqyrjen e Prodekanit për Shëndetësi. Ky organizim bëhet për të gjitha degët e FM-së dhe iniciativa është bërë duke marrë parasysh kapacitetet kadrovike të FM-së për profesionistët shëndetësorë në mbarë Kosovën. Seminaret e edukimit të vazhdueshëm janë duke u realizuar në Qendrën e Telemjekësisë së Kosovës. Deri më tani janë organizuar shumë seminare/ligjërata nga ana e profesorëve të ndryshëm të Fakultetit të Mjekësisë.

AKTIVITETI NË SFERËN E INFRASTRUKTURËS DHE FINANCAVE

Pas miratimit të Ligjit për buxhetin e vitit 2019, si dhe njoftimit nga Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave mbi ndarjet përfundimtare, menaxhmenti i UP-së e ka bërë ndarjen e buxhetit të aprovuar sipas kërkesave dhe nevojave të njësive akademike, si dhe ndarjen e shpenzimeve fikse në nivel të Universitetit. Ky propozim i menaxhmentit për ndarjen e buxhetit është miratuar nga Këshillit Drejtues i UP-së.

Duke u bazuar në ligjet e lartcekura, Buxheti i lejuar i Fakultetit të Mjekësisë për vitin 2019 është si në tabelën vijuese.

Buxheti i ndarë për vitin 2019 – Fakulteti i Mjekësisë

	MALLRA DHE SHERBIME	95.000.00 €	
	MJETE KONKRETIZIMI	95,000.00 €	
	PAJISJE LABORATORIKE	150,000.00 €	
	DEKANATI I RI	250,000.00 €	
	RENOVIME	15,000.00 €	
	INVENTARI I DEKANATIT TE RI	92,500.00 €	
		697,500.00 €	

FAKULTETI I MJEKËSISË- BUXHETI I NDARË PËR VITIN 2019

013000	MALLRA DHE SHËRBIME	95.000.00 €	
013100	SHPENZIMET E UDHËTIMIT	4,000.00 €	Udhëtimet jasht vendit për menaxhmentin e FM
013130	SHPENZ.UDHË.ZYRT.BRENDA VENDIT		
013132	AKOMODIMI-UDH.ZYRT.BREND.VENDI		
013140	SHP.E UDHË.ZYRT.JASHTË VENDIT		
013142	AKOMODIMI-UDH.ZYRT.JASHT VENDI		
013143	SHPEN.TJERA-UDH.ZYR.JASHT VENDI		
013300	SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT	100.00 €	

013310	SHPENZIMET PËR INTERNET		
013320	SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE		
013330	SHPENZIMET POSTARE	100.00 €	Dërgesat postare
013400	SHPENZIMET PËR SHËRBIME	2,000.00 €	
013410	SHËRBIMET E ARSIMIT&TRAJNIMIT	1,000.00 €	
013420	SHËRBIMET E PËRFAQ. TE AVOKATURES		
013440	SHËR.E NDRYSH.INTEL.&KËSHILLDH	600.00 €	
013450	SHËRBIME SHYTYPJE-JO MARKETING	200.00 €	
013460	SHËRB KONTRAKTUESE TJERA		
013470	SHËRBIME TEKNIKE		
013480	SHPENZIMET PËR ANËTARËSIM	200.00	Brenda kodit të ndahen për antarsimin e FM për ORPHEUS
013500	BLER.MOB.&PAIS.ME PAK SE 1000	28,300.00 €	Inventar për Fakultetin e Mjekësisë (mobilje, banka, karriga, perde, kondicioner t ajrit
013501	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	18,300.00 €	
013502	TELEFONA (ME PAK SE 1000 Euro)		
013503	KOMPJUTERË ME PAK SE 1000 Euro		
013504	HARDUER PËR TEK.INFOR. <1000		

013505	MAKINA FOTOKOPJUSE<1000	10,00.00 €	
013506	PAJISJE SPEC.MJEKËSORE <1000		
013509	PAJISJE TJERA <1000		
013510	BLERJA E LIB.DHE VEP.ARTISTIK		
013600	BLERJE TJERA MALLRA & SHËRBIME	51,200.00 €	
013610	FURNIZIME PËR ZYRË		
013620	FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYRTARE)	1,200.00 €	
013630	FURNIZIME MJEKËSORE	50,000.00 €	Furnizimi i laboratoreve me material harxhues /shëndetesor
013640	FURNIZIME PASTRIMI		
013650	FURNIZIM ME VESHMBATHJE		
013660	AKOMODIMI		
013700	DERIVATET & LËNDËT DJEGËSE	- €	
013710	VAJ		
013720	NAFTE PËR NGROHJE QENDRORE		
013730	VAJ PËR NGROHJE		
013770	DERIVATE PËR GJENERATOR		
013780	KARBURANT PËR VETURA		
013901	SHËRB.E REGJISTRIM.&SIGURIMEVE	- €	
013951	SIGURIMI I AUTOMJETEVE		
013952	TAKSA KOMUNALE E REGJIS.AUTOMJETEVE		

013953	SIGURIMI I NDËRTESAVE TJERA		
013950	REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE		
014000	MIRËMBAJTJA	4,000.00 €	Mirëmbajtjet e ndryshme në fakultet
014010	MIRËMB.DHE RIPARIMI I AUTOMJET.		
014020	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	3,000.00 €	
014023	MIRËMBAJTJA E SHKOLLAVE		
014030	MIRËMBAJTJA E AUTO RRUGEVE		
014040	MIRËMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE		
014050	MIRËMB.E MOBILEVE DHE PAJISJEVE	1,000.00	
014200	SHPENZIMET E MARKETINGUT	800.00 €	
014210	REKLAMAT DHE KONKURSET	- €	
014220	BOTIMET E PUBLIKIMEVE	800.00 €	Botimet e publikimeve
014230	SHPENZ PËR INFOR. PUBLIK		
014300	SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT	600.00 €	
014310	DREKA ZYRTARE	600.00 €	Sipas vendimit të KD
013810	Pety cash	4,000.00 €	
031690	RENOVIMI I OBJEKTEVE	15,000.00 €	Renovimimet në objekte sipas specifikave të Fakultetit të Mjekësisë

031690	MJETE KONKRETIZIMI	95,000.00 €	Material laboratorik dhe pajisje të teknologjisë informative (kompjuter, laptop, printer,projektor me pjeset përcjellse)
031690	PAJISJE LABORATORIKE	150,000.00 €	Furnizimi i laboreve me pajisje laboratorike
	OBJEKTET E REJA	250,000.00 €	Vazhdimi i punimeve në objektin e ri të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë

Menaxhmenti i Fakulteti të Mjekësisë, duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin 2019, ka përgatitur raportin e shpenzimeve të buxhetit për periudhën nga 01.01.2019 gjer me 22.12.2019.

Shpenzimet e Fakultetit të Mjekësisë sipas kategorive:

1. MALLRA DHE SHËRBIME

Në tabelën vijuese janë paraqitur shpenzimet në mallra dhe shërbime gjatë periudhës raportuese për vitin 2019:

Tabela 1. Shpenzimet në mallra dhe shërbime të FM sipas kodeve ekonomike

013000	Mallrat dhe shërbimet (95.000.00€)		
--------	---	--	--

013820	Pety cash 4x1000	4,000.00 €	
013501	Mobile, karriga, tavolina etj	18.300.00€	Inventarë për sallat e mësimit në FM
013505	Makinë fotokopjuese	10.000.00€	Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë
013630	Furnizime mjekësore (material harxhues shëndetësor)	50.000.00€	Dega e Mjekësisë Dega e Stomatologjisë Dega e Infermierisë Dega e Fizioterapisë
013480	Shpenzimet për anëtarësim	400.00€	Antarësimi ORFEUS

2. PAJISJE LABORATORIKE

Tabela 2. Shpenzimet për Pajisje Laboratorike për nevojat e Fakultetit të Mjekësisë

31680	Pajisje Laboratorike (150,000.00 €)	
	Dega e Farmacisë Dega e Fizioterapisë Dega e Stomatologjisë Katedra e Biokimisë Mjekësore	150,000.00 €
	Katedra e Anesteziologjis me Reanimacion	
	Katedra e Fiziologjisë me Imunologji	
	Katedra e Anatomisë	
	Katedra e Anatomisë Patologjike	
	Katedra e Histologjisë me Embriologji	
	Katedra e Lëndëve Paramjekësore	

3. MJETE KONKRETIZIMI

Tabela 3. Shpenzimet në Mjete Konkretizimi për nevojat e Fakultetit të Mjekësisë

31600	Mjete Konkretizimi (95.000.00 €)	
	Pajisje të IT	60.000.00€
	Material shpenzues laboratorik	35.000.00€

4. RENOVIMI I OBJEKTEVE

Për renovime të objekteve Fakulteti i Mjekësisë ka patur në dispozicion 15,000.00 € të cilat janë realizuar në bazë të kërkesave të katedrave të Fakultetit të Mjekësisë, por pasi që nuk kanë qenë të mjaftueshme nga ana e rektoratit të UPHP ndahen dhe 15.000.00.€ buxhet shtesë enkas për renovime.

Tabela 4. Renovimet e objekteve në fakultetin e Mjekësisë

31690	Renovimet e objekteve (15,000.00 €)	
	Biblioteka e studentëve në ORL	15,000.00 € dhe 15.000.00€ (buxhet shtesë i ndarë nga UP)
	Dega e Farmacisë	
	Katedra e Anatomisë Patologjike - Instituti A	
	Instituti B	



Instituti B i Fakultetit të Mjekësisë - renovimet në hyrje të Institutit B



Instituti A i Fakultetit të Mjekësisë- Renovimi i tërësishëm i Sallës së Mësimit në Katedrën e Anatomisë Patologjike

5. NDËRTIMI I OBJEKTIT TË RI TË DEKANATIT TË FAKULTETIT TË

MJEKËSISË

Tabela 5. Shpenzimet për ndërtimin e objektit të ri të dekanatit të FM

31700	Vazhdimi i punimeve të ndërtimit të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë	250.000.00 €
--------------	---	---------------------







6. INVENTARI I OBJEKTIT TË RI TË DEKANATIT TË FAKULTETIT TË

MJEKËSISË

Tabela 6. Shpenzimet për inventarin e objektit të ri të dekanatit të FM

	Inventari i Objektivit të ri të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë	92.500.00€
--	---	-------------------

Aktivitetet në punën:

1. Raportim dekanës së Fakultetit të Mjekësisë për buxhetin e ndarë
2. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të nevojave të katedrave të fakultetit të Mjekësisë
3. Përgaditja e kërkesave të fakultetit të Mjekësisë konform vijave buxhetore për njësinë e prokurimit të UP
4. Propozimi i komisioneve vlerësuese për dosjen e tendereve për njësinë e prokurimit të UPHP
5. Propozimi i komisioneve për pranimin e kontratave (furnizim me material shëndetësorë, laboratorik, pajisjeve laboratorike, pajisjeve të IT, renovime të objekteve, etj)
6. Takime të shpeshta me prorektorën për financa të UPHP Prof. Dr. Myrvete Badivuku Pantina lidhur me shpenzimin e buxhetit të ndarë, kërkesave për buxhet shtesë dhe ecurinë e punimeve në objektin e ri të dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë.

SHTOJCA 1: Inventari ne Dekanatin e ri 2019



Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Fakulteti i Mjekësisë
Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381-38-512221 [URL:http://www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)
Fax: +381-38-512223 [Mail:mjekesia@uni-pr.edu](mailto:mjekesia@uni-pr.edu)

Ref. Nr.

Prishtinë

2019

Konform kërkesës të Fakultetit të Mjekësisë drejtuar UPHP, objekti i ri i dekanatit të FM do të furnizohet me inventarin e poshtëshënuar:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Orman i hapur i cili duhet te jete e punuar nga melamine me ku pjesa e sipërme duhet te jete 30mm, duhet te kete pese ndarje horizontale, 76.2 Dimenzionet – 80x42x154h – lejohet devijimi (+-) 10 %, Vrejtje Ormani duhet te ket mrapa iveric 1.5mm	Copë	10
2	Orman me dyer xhami I cili duhet te jete e punuar nga melamine me ku pjesa e sipërme duhet te jete 30mm, ndersa dyert me xham te zalluar te rethuar me alumin , duhet te kete pese ndarje horizontale, 78.1 Dimenzionet – 80x42x190h lejohet devijimi (+-) 10 %, Vrejtje Ormani duhet te ket mrapa iveric 1.5mm	Copë	48
3.	Orman me dyer xhami duhet te jete i punuar nga materiali I njejte sikurse elementet tjera me trashesi 18mm nga druri me rimeso (veneered), dyert duhet te jene nga xhami I zbutur me trashesi 5mm me sistem te hapjes me shtytje, ne mbrendesi duhet te kete 4 sirtarë të punuar nga MDF I llakuar, kembet/mbajteset duhet te jene te punuar nga fletet metalike HRP 5mm te prera dhe formuar me laser. Dimenzioni 124x43x130 – lejohet (+-) 10 %, Vrejtje Ormani duhet te ket mrapa iveric 1.5mm	Copë	9

4	<p>Karrigë statike nga lekura ose skaji. Mbajteset e duarve te jene te kromuara me metoden e injektimit te mveshur me lekure. Dimenzionet</p> <p>Gjerësia e ulëses: 49 cm Thellësia e ulëses: 44 cm Lartësia e ulëses: 48 cm Lartësia e mbështetëses: 48 cm Gjerësia e mbështetëses: 49 cm Gjerësia e përgjithshme: 57 cm Lejohet devijimi (+-) 5 %</p>	Copë	156
5	<p>Kasetë metali me kater fijoka, materiali metal me nje qeles qe i mbylle te gjitha fjokat, dim. Standard,Qertifikatat EN 14073.2004 dhe autorizim nga prodhuesi .</p>	Copë	4
6	<p>Ormana metali per dokumenta, me rafta per vendosjen e dokumenteve, dimensiononi 1850x900x390 mm, lejohet devijimi (+-) 10 %,Qertifikatat EN 14073.2004 dhe autorizim nga prodhuesi .</p>	Copë	50
7	<p>Tavolinë per trajnime 90x50x75 nga materiali melamin 25 mm, lejohet devijimi (+-) 10%</p>	Copë	2
8	<p>Tavolinë pune e thjeshte nga materiali melamin, Dimenzionet 140, 160 ose 180cm gjatesi. mundesia e devijimit te dimensionit +-10%</p>	Copë	25
9	<p>Karrigë per zyre, me rrota, levizese me mundesi ngritje -ulje , me mbeshtetese per duar sipas dizajnit ne foto Dimenzionet 53 Gjerësi x 63 Thellësi x 104-110.5 Lartësi cm, mundesia e devijimit te imensionit +-5%</p>	Copë	35
10	<p>22.1 Tavolinë pune – e cila duhet te jete e punuar nga MDF me trashesi 42 mm me metodë speciale. Struktura e kembeve duhet te jete nga metali 40x20 mm me profile te formuara si kuti 15x15 mm me strumbulla te veçanta të aluminit. Këmbët te lyera me elektrostetike me pluhur, duhet te kete dy fioka me system te hapjes ne shtytje, dhe te kete kalimin e kablllove dhe shtekun te fshehur. Dimenzionet 260x90x75. lejohet (+-) 10 %</p>	Copë	1

11	26.1 Tavolinë pune e punuar nga melamine me trashesi 30mm, kembet duhet te punohen nga profile te aluminit ku njera kembe duhet te jete e gjere 18mm dhe tjetra e ngusht 8mm. Dimenzioni – 180x82x73.	Copë	6
12	Tavolinë pune e punuar nga melamine 18mm me perfundim nga PVC 2mm, kembet te punohen nga profilet special pentagonal 50x20mm. Dimenzionet 160x80x72.3 – Per çdo dimension lejohe (+-) 10 %	Copë	5
13	Karrikë lëvizese ekzekutive me mbështetëse të lartë e cila duhet te jete e punuar me strukture monoblok e mbuluar me sfungjer te shtypur i formuar nga myku special me 45-50 densitet DNS (kg / m3) në plastikë të posaçme, ulesja duhet te jete nga tubi metalik me sfungjer te ngjeshur me 45-50 densitet DNS (kg / m3) ergonomike, mbajtset e duarve te jene te kromuara me metodën e injektimit te mveshur me lekure, mekanizmi i rregullimit te mbeshteteses para dhe mbrapa ne kater pozicione, gas lift i klasit te 4 sipas normave europiane DIN dhe trungj absorbues, baza e aluminit te injektuar me myk te vecante me diameter 65cm ne form piramidale, rrotat te jene pa vide me diameter 65mm. Lekura te kete kete permbajtje : 550-600 g/m2 ,% 2 PU % 65 PVC % 22 PES % 11 Pambuk. Dimenzionet - L55 W64 H138 – devijimi i lejuar +- 5 %	Copë	7
